



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1067/ 9 prot.

Datë 26/06/2026

V E N D I M
Nr. 883/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26/06/2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 801/2026, datë 15.06.2026 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-80210-03-27-2026, me objekt “*Blerje mobilje*”, me fond limit 12,494,001 (*dymbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e një*) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 21.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Klame” SHPK me NIPT K21518003F dhe adresë: Rruga “Gani Kryeziu”, Nr.23, Kati i dytë, Kodër-Kamëz, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.
Adresa: Pranë Stadiumit Himarë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e*

Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 15.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 801/2026, ku vendosi:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “KLAME” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-80210-03-27-2026, me objekt “Blerje mobilje”, me fond limit 12,494,001 (dymbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e një) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 21.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.*
- 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-80210-03-27-2026, me objekt “Blerje mobilje”, me fond limit 12,494,001 (dymbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e një) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 21.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.*
- 3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
- 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK.*
- 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.*
- 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 362/18 prot., datë 17.06.2026, me objekt “Mbi zbatimin e vendimit nr. 801/2026, datë 16.06.2026 për procedurën e prokurimit me Ref-80210-03-27-2026 dhe objekt Blerje mobilje”, protokolluar me tonën nr. 1067/6 prot., datë 22.06.2026, autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, informon se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 801/2026, datë 15.06.2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-80210-03-27-2026, me objekt “Blerje mobilje”, me fond limit 12,494,001 (dymbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e një) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 21.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 362/18 prot., datë 17.06.2026, me objekt “Mbi zbatimin e vendimit nr. 801/2026, datë 16.06.2026 për procedurën e prokurimit me Ref-80210-03-27-2026 dhe objekt Blerje mobilje”, protokolluar me tonën nr. 1067/6 prot., datë 22.06.2026, autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, informon se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 801/2026, datë 15.06.2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-80210-03-27-2026, me objekt “Blerje mobilje”, me fond limit 12,494,001 (dymbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e një) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 21.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike shtojcës së publikuar në SPE, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor ka hartuar dhe publikuar shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga verifikimi i së cilës konstatohet se ky i fundit ka modifikuar dhe publikuar ndryshimet në shtojcë sipas përcaktimeve të bëra në vendimin KPP Nr. 801/2026, datë 15.06.2026.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-80210-03-27-2026, me objekt “Blerje mobilje”, me fond limit 12,494,001 (dymbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e një) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 21.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mezini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

